

# Ndihma Dhe Perkujdesja në shtëpi SPITEX-I



Überall für alle

**SPITEX**  
Mittleres Tösstal

## KUJT DUHET TI DREJTOHEM NËSE KEMI NEVOJË PËR NDIHMË NË PUNËT SHTËPIAKE OSE PËR PËRKUJDESJE NË SHTËPI?

Persona të kualifikuar në këtë profesion i mbështesin dhe perkujdesen për pacientë të të gjitha moshave të cilët kanë nevojë për kujdes dhe mbikqyrje në shtëpi Spitexi i ndihmon familjarëve që perkujdesen për të afërmit e tyre në nevojë.

## ÇKA BËN SPITEXI?

Për në Spitexi mund të bëjnë kërkesë personat që kanë sëmundje trupore dhe mendore, pleqët që kanë nevojë për kujdes, të aksidentuar, nënat pas lindjes dhe në rast të komplikimeve gjatë shtatzanisë.

Shërbimet e Spitexit përfshijnë:

### Përkujdesje në shtëpinë tuaj:

- Sqarime dhe këshilla për kujdesin mjekësor
- Këshilla për ofertat mjekësore
- Ndihmë në mirëmbajtjen e trupit
- Ndihmë gjatë lëvizjeve në shtratë (mobilizim)
- Përgaditja dhe administrimi i medikamenteve
- Vizita mjekësore siç janë, sëmundja e sheqerit (diabeti) dhe shtypja e gjakut si dhe të tjera
- Trajtimi dhe parandalimi i dhimbjeve
- Shërimi dhe pastrimi i plagëve
- Përcjellja e të vdekurve

### Ndihmë në punët shtëpiake:

- Mbështetje gjatë pazarit
- Pastrimi i shtëpisë
- Larja e rrobave
- Gatimi

### Sipas Rajonit Spitexi orfon dhe:

- Shujta të ushqimeve (shërbimi i ushqimit)
- Vozitje dhe shoqërim tek mjeku ose për blerje
- Dhënje me qera e objekteve ndihmëse (paterica, aparate për inhalim dhe karrocë për invalidë)

Shërbime të tjera por që kryesisht ofrohen nëpër qytete janë: trajtim psikiatrik, kujdes mjekësor në rastë kanceri ose të sëmundjeve tjera të pashërueshme



## ÇKA PAGUAN SIGURIMI SHËNDETËSOR?

Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor paguan shërbime mjekësore, mirëpo për këtë nevojitet një koordinim ose mirëkuptim në mes të Spitexi-it dhe mjekut.

## ÇKA NUK PAGUAN SIGURIMI SHËNDETËSOR?

Ndihma në punët e shtëpisë nuk paguhet nga sigurimi bazë i sigurimit shëndetësor. Për këto arsye në shumë sigurime shëndetësore mund ta zgjidhni një sigurim shtesë mbrenda sigurimit bazë. Për më shumë informacione kontaktoni sigurimin tuaj shëndetësor. Nëse ju përfiton ndihma nga shteti dhe nuk keni mundësi për pagimin e shërbimeve, atëherë një pjesë të pagesës e paguan bashkia (komuna).

## ÇKA DUHET TË PAGUAJ KLIENTI?

- Shuma vjetore e sigurimit shëndetësor
- 10 % e shpenzimeve të shërbimeve mjekësore (pagesa vetanake e sigurimit shëndetësor)
- Pjesëmarrje e pacientit në pagimin e shërbimeve mjekësore (shuma mbi 15.95 CHF në ditë sipas kantonit – Turbenthal, Wila, Wildberg: 8.-- CHF)
- Shpenzimet gjatë ndihmës në punët e shtëpisë

Me mbështetjen profesionale dhe financiare të migesplus

**Schweizerisches Rotes Kreuz** 

www.migesplus.ch

Informacione shëndetësore në shumë gjuhë

- [www.spitex-toesstal.ch](http://www.spitex-toesstal.ch) -> Spitexi në zonën tuaj
- Email: [info@spitex-toesstal.ch](mailto:info@spitex-toesstal.ch)
- Telefon: 052 385 23 30